VENDIM
Nr. 237, datë 5.11.2024

MBI MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË "KODIN E RRJETIT TAP" DHE "KODIN TARIFOR TË TAP-it" PROPOZUAR NGA TAP AG, MË 29 TETOR 2024

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 13; 15, pika 1, germa "a"; 16, pika 24 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 qershor 2013, lëshuar nga autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, ("Opinioni Përfundimtar i Përbashkët"), si dhe Opinionit 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013; të neneve 15 dhe 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2261/1 prot., datë 4.11.2024, të Drejtorisë së Gazit Natyror "Mbi miratimin e një ndryshimi në 'Kodin e Rrjetit TAP' dhe 'Kodin Tarifor të TAP-it' të propozuar nga TAP AG më 18 shtator 2024, bashkëngjitur si aneks B dhe aneks C",

Konstatoi se:

- Më datë 1 shtator 2011, TAP AG paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë (ERE) "Aplikimin e Përjashtimit për Gazsjellësin Trans Adriatik", në përputhje me nenin 22 të Direktivës 2003/55/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2003, mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror (direktiva e gazit).

- Në muajin qershor 2013, Ministria Italiane, Autoriteti Rregullator Grek (RAE) dhe ERE morën vendimin për përjashtimin nga dispozitat e nenit 9, nenit 32 (Aksesi i Palëve të Treta – TPA) dhe nenit 41.6, 41.8, 41.10 (tarifat e rregulluara) të Direktivës së Gazit për kapacitetin fillestar prej 10 miliardë metër kub në vit, sipas disa kushteve, duke përshtatur Opinionin Përfundimtar të Përbashkët (këtu dhe më poshtë "FJO"), një dokument i hartuar së bashku nga ARERA, ERE dhe RAE (këtu dhe më poshtë "Autoritetet") dhe ndryshuar për t'u përputhur me vendimin e Komisionit [C(2013)2949 përfundimtar], datë 16 maj 2013:

- Opinionin 1/2013 të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013;
- Direktivën 2009/73/EC të Parlamentit Evropian të datës 13 korrik 2009;
- Direktivën (BE) 2024/1788 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 qershor 2024;
- Direktivën e BE 2019/692 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 17 prill 2019;
- Rregulloren 715/2009/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009;
- Rregulloren 2019/942/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 5 qershor 2019;
- Rregulloren (BE) 2024/1789 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 qershor 2024;
- Rregulloren e Komisionit (BE) 312/2014 të datës 26 mars 2014;
- Rregulloren e Komisionit (BE) 2017/459 të datës 16 mars 2017.

- Më datë 16 mars 2017, është miratuar rregullorja e re e BE 459/2017 "Për Kodin e Tarifave, TAR NC".

Duke konsideruar se:

- Pas detyrimeve të FJO-së dhe pas konsultimit publik, Kodi i Rrjetit u miratua fillimisht nga Autoritetet në vitin 2020 (vendimi ARERA 218/2020/R/gas, vendimi ERE nr. 97, datë 15.6.2020 dhe vendimi RAE nr. 1036/2020 – Fletorja e Qeverisë B' 2928/17.7.2020). Vendimi nr. 115, datë 30.3.2023, "Për miratimin e një ndryshimi të Kodit të Rrjetit TAP" me propozim të tij dhe me vendim të përbashkët të tre rregullatorëve: RAAEY, ARERA dhe ERE. Vendimi nr. 168, datë 19.7.2018, "Për

miratimin e ndryshimeve të propozuara nga TAP AG në metodologjinë e tarifave të TAP AG të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 127, datë 7.11.2013".

Opinion i Përbashkët Përfundimtar parashikon, gjithashtu, në nenin 4.7.1, që TAP AG i ka dorëzuar për miratim ARERA, ERE dhe RAAEY (autoriteteve) Kodin e Rrjetit TAP ose TNC; dymbëdhjetë muaj para fillimit të aktivitetit tregtar dhe, në përputhje me Opinionin e Përbashkët Përfundimtar, TNC duhet të jetë i pajtueshëm me Kodet e Rrjetit Evropian në pjesët që nuk janë në konflikt me të njëjtin dokument. Në TNC, në shtojcën 5, parashikohet që në pikën 4 TAP AG të vlerësojë të paktën një herë në vit nëse ka kërkesë të mjaftueshme për produkte qëndrueshmërie brenda ditës dhe, nëse është e nevojshme, të përditësojë Kodin për të lejuar ofertën e produkteve të lartpërmendura. Kodi i Rrjetit TAP u miratua me parashikimin e zhvillimeve të ardhshme, bazuar në përvojën e fituar operacionale të transportuesit që nga data e operacioneve tregtare.

Zhvillimet e parashikuara që në fillim janë renditur në shtojcën 5. Ndër to, TAP AG *"do të shqyrtojë, të paktën çdo vit, duke filluar dy vjet pas datës së operacioneve tregtare, nëse ka kërkesë të mjaftueshme për ofrimin e produkteve brenda ditës dhe, nëse po, do të vlerësojë: (a) ndikimet e tjera operacionale të ofrimit të produkteve brenda ditës; dhe (b) produktet që mund të ofrohen nga OST-të fqinje në sistemet e ndërlidhura. Nëse më pas vendos se është e përshtatshme, transportuesi do të përgatisë një propozim rishikimi në përputhje me seksionin 22.4 për të inkorporuar produktet brenda ditës brenda Produkteve të Kapacitetit të ofruara."*

Me letrën e datës 29 tetor 2024 (referenca e TAP-it: LT-TAP-NRA-00062), TAP AG u kërkoi autoriteteve miratimin e ndryshimeve në TNC dhe TTC, siç përcaktohet në vendimin përfundimtar të TAP AG, bashkëngjitur me anekset e tij. TAP-i ndërmori një konsultim publik midis 12 korrikut dhe 12 gushtit 2024 mbi Propozimin e Rishikimit për TNC-në dhe Kodin Tarifor të TAP-it. Ky Propozim Rishikimi synon të prezantojë një produkt brenda ditës (WD) në TAP, të përmirësojë procesin e regjistrimit dhe të integrojë elementët e përputhshmërisë të marrëveshjeve të transportit të gazit (GTA) të TAP-it në TNC. TAP AG nuk ka marrë asnjë koment gjatë konsultimit publik.

Rishikimet kryesore të synuara të TNC dhe TTC janë përmbledhur më poshtë:

a) Zbatimi i produkteve brenda ditës: oferta e kapacitetit *forward* brenda ditës që vihet në dispozicion për transportin e gazit natyror për periudhën e orëve të mbetura në një ditë gazi, deri në ditën e plotë të gazit, dhe ai produkt i kapacitetit rezervohet para ose gjatë ditës përkatëse të gazit, por pas mbylljes së ankandeve të ditës së përpara për atë ditë të gazit;

b) Shumëzuesi i produkteve brenda ditës: tabela e shumëzuesve (përdorur nga TAP AG për të përcaktuar çmimin rezervë të ankandit për produktet me afat më të shkurtër se një vit) për tarifat tremujore, mujore dhe ditore është përditësuar duke shtuar një shumëzues brenda ditës 1.4;

c) Tarifa e funksionimit për produktin brenda ditës: një tarifë operimi në euro do t'i paguhet TAP AG për çdo rezervim të kapacitetit të firmës *forward* brenda ditës, i bërë me sukses nga një Palë e Regjistruar; tarifa e operimit e aplikueshme për *Forward Firm Within-Day Capacity* është projektuar për të kompensuar TAP AG për kostot operacionale shtesë të bëra si rezultat i prezantimit dhe ofrimit të kapacitetit *forward firm* brenda ditës dhe si i tillë nuk bën pjesë dhe do të trajtohet veçmas nga tarifa. Kjo do të thotë se të hyrat nga kjo tarifë nuk do të trajtohen si të hyra shtesë që do të rishpërndahen sipas par. 4.7.10 i FJO;

d) Përditësimi i procedurës së regjistrimit: të *Konfirmimi i regjistrimit* procedura e përcaktuar në par. 3.1(f) (zakonisht zgjat 30 ditë) zgjatet me një periudhë të arsyeshme të përcaktuar sipas gjykimit të TAP AG në rrethana të veçanta; për më tepër, sqarohet se TAP-i mund të kërkojë, sipas gjykimit të tij, që Pala e Regjistruar të ridorëzojë përgjigjet ndaj pyetësorit të Integritetit Due Diligence;

e) Futja e masave kundër ryshfetit dhe korrupsionit: shtojca 6 e dedikuar është shtuar për të garantuar përputhshmërinë me dekretin legjislativ italian nr. 231/01;

f) Autoriteti, së bashku me RAAEY dhe ARERA, ka përgatitur tekstin "Miratimi të një ndryshimi në 'Kodin e RRjetit TAP' dhe 'Kodin Tarifor TAP' të propozuar nga TAP AG më 29 tetor 2024, shtojca A e kësaj dispozite,

e cila përfshin miratimin e përbashkët të ndryshimeve në Kodin e Rrjetit TAP dhe të Kodit Tarifor TAP i raportuar në shtojcën B dhe shtojcën C përkatësisht.

Në këtë dokument të përbashkët njihet, se:

- Ndryshimet e propozuara të Kodit të Rrjetit TAP dhe Kodit Tarifor të TAP-it janë në përputhje me FJO dhe me rregulloret e BE-së.

- Ky dokument i përbashkët është miratuar nga Enti Rregullator i Italisë dhe Enti Rregullator i Greqisë.

Prandaj, është e nevojshme të miratohet drafti i dokumentit të përbashkët "Miratimi i një ndryshimi në "Kodin e Rrjetit TAP" dhe "Kodin Tarifor të TAP", propozuar nga TAP AG, më 18 shtator 2024, bashkangjitur si aneks B dhe aneks C."

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim dokumentin e përbashkët të tre rregullatorëve të energjisë, ERE, RAE dhe ARERA: "Miratimi i një ndryshimi në "Kodin e Rrjetit TAP" dhe "Kodin Tarifor të TAP", propozuar nga TAP AG, më 18 shtator 2024, bashkëngjitur si aneks B dhe aneks C".

2. Të publikojë këtë vendim në faqen e internetit të ERE-s: www.ere.gov.al.

3. Versioni në gjuhën origjinale (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë TAP AG për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti